


REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF
KOSOVO
KOMUNA E HANIT TË ELEZIT
MUNICIPALITY OF HANI I ELEZIT



NJOFTIM

Në bazë të ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, neni 68, Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna, Kryetari i Komunës fton qytetarët për:

PLANI I PUNËS SË KRYETARIT

Njofohen të gjithë qytetarët e Komunës së Hanit të Elezit, grupet e interesit dhe palët e tjera që janë të interesuar, se Komuna e Hanit të Elezit, organizon debat publik për diskutim mbi Planin e Punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2024.

Takimi publik do të mbahet me datë 26.12.2023, tek Qendra e Kulturës "Imri Curri" në Han të Elezit, duke filluar nga ora 10:00.

Në këtë takim do të keni mundësi të diskutoni mbi planin e punës për vitin 2024. Takimi është i hapur për të gjithë dhe mund ti propozoni kërkesa në lidhje me planin e punës së Kryetarit të Komunës dhe ekzekutivit të Komunës për të gjitha temat të cilat ju doni ti trajtoni. Të drejtë pjesëmarrje kanë të gjithë qytetarët e Komunës së Hanit të Elezit.

Ndërsa komentet dhe sugjerimet e tjera, mund t'i përcillni deri me datën 26.12.2023 në ora 14:00, në adresat elektronike ballazhi@rks-gov.net dhe sevdi.dernjani@rks-gov.net